

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	John Ternus surprizon në Emmy Awards, prezanton para kamerave iPhone Duo
ADRESA	https://albeu.com/teknologji/john-ternus-surprizon-ne-emmy-awards-prezanton-para-kamerave-iphone-duo/1012661/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:03:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 12:58:40 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	890eed8abaeed11117edf127ceeeab2e1ed3149ab4ca3ffe35b5d6aa5549bac6
TEKSTI	c69ac5a9b65546b3c429cdb75452a7bbddfd46a17aa8ac0ad05302e7caf05447
PAMJA	6d5df781d07d423d2621027cf288a4e87a8ddb6d2455343c518565ca5918adac

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b582ad5a37442bdadaec528667cdd0df401768a928b26c5581700ac6769e0b78
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b582ad5a37442bdadaec528667cdd0df401768a928b26c5581700ac6769e0b78>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

John Ternus surprizon në Emmy Awards, prezanton para kamerave iPhone Duo



CEO i ri i Apple, John Ternus, u shfaq papritur në ceremoninë Emmy Awards, ku tërhoqi vëmendjen duke nxjerrë në pah publikisht iPhone Duo, telefonin e parë të palosshëm të kompanisë.

“Dëshironi ta shihni?”, i tha Ternus një gazetareje të “Deadline”, përpara se pajisjen ta nxirrte nga xhepi i brendshëm i smokingut.

Reagimi i entuziazmuar i gazetares u regjistrua në një video 13 sekonda, e cila më pas u shpërnda me shpejtësi në rrjetin social X.

Personi më cool në sallë

Videoja me iPhone Duo nxiti reagime të shumta në internet. Përdoruesit komentuan si pamjen e telefonit, ashtu edhe paraqitjen e Ternus.

“Prisni, nuk po e shoh dot ekranin. A është ndriçimi shumë i ulët?”, pyeti një përdorues.

Një tjetër komentoi me humor se të shfaqeshe në Emmy Awards me një pajisje të re, të cilën nuk e kishte askush tjetër, ishte një demonstrim i madh dhe se Ternus duhet të ishte ndier si personi më cool në sallë.

Apple e prezantoi zyrtarisht iPhone Duo vetëm pak ditë më parë. Megjithatë, shitjet e tij pritet të nisin vetëm në fund të tetorit.

Pavarësisht kësaj, Ternus e mori një nga pajisjet me vete në ceremoninë e zhvilluar në Los Angeles.

E hapi telefonin para kamerave

Në pamjet e shkurtra, Ternus e nxjerr iPhone Duo nga xhepi, e hap për të treguar ekranin e madh të brendshëm dhe më pas e palos sërish, përpara se ta vendosë në xhakëtë.

të fundit /



John Ternus surprizon në Emmy Awards, prezanton para...



Ron Raçi shpallet pjesë e formacionit të javës në Kroaci pas...



Jack Thorne ngre shqetësimin për ndikimin e IA-së te...



Range Rover ndryshon drejtim: më pak ekrane për një kabinë më të...



Genesis X Skorpio ngjitet në malin italian me 1,100 kuaj fuqi



Flick synon ta drejtojë Barcelonën në finalen e Champions League n...



Përplasja në Komisionin e Ligjeve, Korreshi i përgjigjet...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Çmimi i pajisjes është rreth 2,337 euro, bazuar në vlerën britanike prej 1,999 paundësh.

Disa përdorues vunë re se ekrani dukej mjaft i errët në video.

Në fillim u ngritën dyshime se Ternus mund ta kishte ulur ndriçimin për arsye sigurie, por Apple ka deklaruar se kjo pamje lidhet me teksturën e veçantë të ekranit.

Kompania shpjegon se sipërfaqja premium "nano-texture" kufizon shkëlqimin dhe reflektimet. Efekti mat, sipas Apple, ndihmon gjithashtu që vija e palosjes të jetë më pak e dukshme.

Përdoruesit vërejnë mungesën e vijës së palosjes

Një ndër mangësitë më të përhapura të telefonat e palosshëm ka qenë shenja e dukshme në qendër të ekranit.

Megjithatë, në pamjet e iPhone Duo, shumë përdorues pretenduan se kjo vijë mezi dallohej.

"Zero vijë palosjeje. Zero", shkroi një komentues.

"Nuk mund ta shohësh fare vijën e palosjes. Apple ka bërë një punë të jashtëzakonshme", deklaroi një tjetër.

Vëmendja e publikut nuk u përqendrua vetëm te telefoni, pasi edhe paraqitja e Ternus mori komente të shumta.

"Nuk po gënjej, Ternus duket si 007", shkroi një fans.

Një tjetër përdorues komentoi se të shfaqeshe në Emmy Awards me smoking dhe me një telefon që nuk e kishte askush tjetër në botë përfaqësonte "energji të çmendur".

Ngjashmëri me Galaxy Z Fold8

iPhone Duo ka një trup të gjerë, me hapje në formë libri, që ngjan me Samsung Galaxy Z Fold8.

Pas hapjes, ekrani ka gjerësi më të madhe se gjatësia.

Të dy ekranet, ai i jashtëm dhe ai i brendshëm, kanë raportin 1.4. Ky konfigurim synon të shmangë deformimin e aplikacioneve ose krijimin e hapësirave boshe kur përdoruesi kalon nga një ekran te tjetri.

Ekrani i jashtëm ka madhësi 5.4 inç, ndërsa ekrani i brendshëm është 7.6 inç.

Përdorimi si laptop i vogël

iPhone Duo mund të përdoret në disa pozicione të ndryshme.

Pajisja mund të lihet gjysmë e hapur për të parë filma pa qenë nevoja të mbahet në dorë, ose të përdoret pjesërisht e palosur, në një mënyrë të ngjashme me një libër.

Procesori i ri A20 Pro pritet të sjellë edhe mundësi të avancuara për multitasking, duke lejuar ekzekutimin e

aplikacioneve të ndryshme në dy pjesët e ekranit.

Mbështetja e parë për Apple Pencil

Një prej risive kryesore të modelit është përputhshmëria me Apple Pencil.

Sipas Apple, ekrani i iPhone Duo do të punojë me lapsin digjital në mënyrë të ngjashme me iPad-in. Kjo e bën pajisjen iPhone-in e parë që mbështet këtë aksesori.

Në pjesën e pasme, telefoni është pajisur me një kamerë kryesore 48 megapikselë, të njëjtën kamerë që përdoret edhe te iPhone 18 Pro.

Me ekranin e palosshëm, mbështetjen për Apple Pencil dhe procesorin A20 Pro, iPhone Duo shënon hyrjen e Apple në një treg ku Samsung dhe prodhues të tjerë kanë konkurruar prej vitesh. /GazetaExpress/

Shtuar më 15.09.2026 14:58

Tags: [AutoTech](#)



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

[Kontaktimi](#) | [Kushtet e Përdorimit](#) | [Privacy Policy](#) | [Powered by: orihost.com](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.